



# Republika e Kosovës

## Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency

I nderuar Z. Kelmendi,

Jam duke shqyrtuar edhe njëherë dokumentin që më keni dërguar më 27.10.2020 (shih dokumentin e parë bashkëgjitur). Unë kam menduar se ky dokument më është dërguar gabimisht për faktin se unë jam anëtar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC) që nga janari, 2016. Gjatë pesë vitet të mëparshme asnjëherë nuk më është kërkuar të deklaroj pasurinë. Sidoqoftë, pasi mora një email nga Dr. Luboteni me një dokument bashkëgjitur nga Agjencia Kundër Korrupsionit, i cili thotë se anëtarët ndërkombëtarë të KSHC-së duhet të deklarojnë pasurinë, ndiej nevojën për t'ju kontaktuar direkt (shih dokumentin e dytë bashkëgjitur).

Së pari, unë besoj se është bërë një gabim nga Zyra e Ministrit të Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MESTI), që emrat tanë (Herbert Amato, Jeffery Butel dhe Magdalena Ziolo) janë dërguar në zyrën tuaj. Asnjëherë më parë zyra e Ministrit nuk i ka konsideruar tre anëtarët ndërkombëtarë si zyrtarë publikë. Ne nuk jemi informuar për një gjë të tillë me rastin e emërimit tonë dhe ky nuk ka qenë një nga kushtet e emërimit. Siç duket, kjo gjë është duke u zbatuar në mënyrë retrospektive. Meqenëse anëtarët ndërkombëtarë nuk janë as shtetas e as banorë të Kosovës, unë shpresoj që të gjithë pajtohemi se përfshirja jonë në këtë listë është një gabim i cili do të korrigjohet tani në përputhje me rrethanat.

Së dyti, nëse nga ne anëtarët ndërkombëtarë kërkohet të deklarojmë informata të tilla, paraprakisht duhet të marrim përgjigje në pyetjet e mëposhtme:

1. Si e përkufizon Agjencia Kundër Korrupsionit mosdeklarimin e pasurisë?
2. A është kërkesa që ne të deklarojmë vetëm pasuritë e fituara në Kosovë (p.sh. honoraret, pasuritë, dhuratat)?

3. A është kërkesa që ne të deklarojmë pasuritë e patundshme, kursimet dhe të ardhurat vjetore që kemi dhe/ose që kemi fituar jashtë Kosovës? Në rastet tona: në Shtetet e Bashkuara, në Mbretërinë e Bashkuar dhe Poloni.

4. Cili është procesi i verifikimit për çdo informacion të dhënë?

Nëse na kërkohet të deklarojmë pasuri, ju lutemi përgjigjuni këtyre pyetjeve sa më shpejt që të jetë e mundur në mënyrë që ne, tre anëtarët ndërkombëtarë, të vendosim nëse do të paraqesim dokumentacionin e kërkuar apo të japin dorëheqje nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë. Në këtë moment, nuk besoj se ndonjëri nga ne të tre do të paraqesë informacione mbi pasuritë që kanë të bëjnë me vendet tona të origjinës.

Ju faleminderit për kohën tuaj.

**Herbert Amato**

Prodekan i asocuar për Akreditim  
Universiteti James Madison  
Harrisonburg, VA, SHBA

**Jeffery Butel**

Konsulent  
Ndërkombëtar  
Mbretëria e Bashkuar

**Magdalena Ziolo**

Prof. e Asoc., Universiteti  
i Universiteti i Szczecin-it  
Szczecin, Poloni